



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINË
DREJTORIA E ARSIMIT
04 Nr. 111-4489 2015
Klinë, më 03.08.2015

Mbështetur në nenin 8, pika 1, të Ligjit të punës nr. 03/L-212 si dhe në nenin 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L 068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, si dhe në normativin mbi përzgjedhjen e kuadrit profesional të arsimit të përgjithshëm nr. 06/2015 dhe UA nr. 05/2015 normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Drejtoria Komunale e Arsimit në Klinë publikon:

K O N K U R S

Për kuadër mësimdhënës për vitin shkollor 2015/2016 në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në Komunën e Klinës

I. Shkolla fillore “Emin Duraku” Sferrkë

Një mësimdhënës për Gjuhë angleze me 12 orë

Një mësimdhënës për Mësim klasor

II. Shkolla fillore “Azem Bejta” në Grabanicë

Një mësimdhënës për Gjuhë angleze me 10 orë

Një mësimdhënës për Gjuhë angleze me 20 orë në Këpuz

Një mësimdhënës për Matematikë me 15 orë në Këpuz

III. Shkolla fillore “Dëshmorët e Qëndresës” Gllarevë

Një mësimdhënës për 20 orë Matematikë-Informatikë (14 orë Matematikë dhe 6 orë Informatikë)

IV. Shkolla fillore “Ali Krasniqi” Ujmirë

Një mësimdhënës për Gjuhë angleze me 7 orë

Një mësimdhënës për TIK me 8 orë

V. Shkolla fillore “Atë Shtjefën Gjeçovi” Zllakuqan

Një mësimdhënës për Gjuhë angleze me 12 orë

Një mësimdhënës për Fizikë 10

VI. Shkolla fillore “Esad Mekuli” Cerovik

Dy mësimdhënës për mësim klasor

VII. Shkolla fillore “Isa Boletini” Drenoc

Një mësimdhënës për Mësim klasor Drenoc

Një mësimdhënës për Muzikë me 8 orë (4 në Drenoc 4 në Poterq)

VIII. Shkolla fillore “Ymer Berisha” Siqevë

Dy mësimdhënës për mësim klasor.

IX. Shkolla fillore “Nënë Tereza” Budisalc

Një mësimdhënës për Fizikë me 8 orë

Një mësimdhënës për Edukatë Fizike me 8 orë

X.Shkolla fillore “ Motrat Qiriazi ” Klinë

Një edukator për parafillor në zëvendësim deri të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë

XI.Shkolla fillore “ Atë Gjergj Fishta” Jagodë

Një mësimdhënës për Matematikë me 15 orë

Një mësimdhënës për Fizikë me 8 orë

XIV. Shkolla fillore “ Ismet Raci “ Klinë

Një mësimdhënës për gjuhë angleze deri të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë

XVI.Shkolla e mesme e lartë-Gjimnazi “Luigj Gurakuqi ” Klinë

Katër profesorë për Matematikë me norma të plota

Një profesor për Gjuhë Frengje 12 orë

XVII. Shkolla e mesme profesionale “ Fehmi Agani “ Klinë

Nje profesor për Gjuhë angleze me 20 orë

Një profesor për Elektroteknikë me 20 orë

UDHËZIM PËR APLIKIM

- 1.Aplikacionet merren dhe dorëzohen në DKA bashkë me fotokopjet e dokumentit të kualifikimit dhe me fotokopjen e certifikatës së lindjes si dhe fotokopje të ndonjë dëshmie shtesë (licenca, trajnime, përvoja e punës në arsim etj.) brenda orarit zyrtar të punës (prej orës 8-16). Dokumentet e pakompletuara nuk do të pranohen si dhe dokumentet e konkurrimit nuk kthehen.
2. Afati i konkurrimit është 10 ditë nga data e publikimit. Intervistimi i kandidatëve do të fillojë më 19 gusht në shkollat ku do të kenë konkurruar kandidatët.
- 3.Në intervistë do të ftohen 3 kandidatë që i plotësojnë kushtet në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2015 ,UA nr.05/2015 si dhe UA nr.17/2009 për procedurat e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë.
4. DKA-ja orarin e intervistimit dhe kandidatët e listës së ngushtë do ta bëjë publike në faqen zyrtare të komunës dhe në shpalljet tek hyrja e objektit komunal.

Rangimi i kandidatëve për listen e ngushtë do të bëhet sipas këtyre kritereve :

- 1.Bachelor i fushës arsimore + Master i fushës përkatëse
- 2.Bachelor i fushës arsimore + Master i papërfunduar i fushës përkatëse
- 3.Fakultet 4 vjeçar i fushës përkatëse arsimore
- 4.Bachelor i fushës përkatëse arsimore
- 5.Student i bachelorit në fushën përkatëse arsimore
- 6.Ish- mësimdhënësi i pakualifikuar

Nëse kandidatët dalin me pikë të njëjta , atëherë vendoset si vijon:

Merret parasysh Masteri përkatës i përfunduar ose.i papërfunduar.

Përvoja e punës në arsim.

Nota mesatare e studimeve.

